
PËRKUFIZIMET E ALPEX-it

PËRKUFIZIMET DHE AKRONIMET TË PERDORUARA NË RREGULLAT E ALPEX-IT DHE PROCEDURAT

Vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe, referencat në këtë dokument të Kapitujve, seksioneve dhe paragrafëve janë referencat të dispozitave të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave.

A - J

| | |
|---|--|
| Agjent i Transaksioneve | nënkupton entitetin ose entitetet me detyrën e transferimit të Pozicioneve Neto ndërmjet Kundërpalëve Qendrore |
| Agjent Klerues i Certifikuar | Nënkupton një person i cili është certifikuar nga ALPEX për të kryer operacionet e Klerimit dhe Shlyerjes në emër një Anëtar Klerimi lidhur me Transaksionet e Energjisë Elektrike në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Agjent Tregtar i Certifikuar | Nënkupton një person i cili është certifikuar nga ALPEX dhe është përgjegjës dhe i autorizuar për të kryer tregtimin në emër të një Anëtar të Bursës në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Algoritmi për Bashkimin i Çmimit | Algoritmi i përdorur në Bashkimin e vetëm të Ditës në Avancë për qëllim të përputhjes të njëkohshme të urdhërporosive dhe kapaciteteve ndërkufitare të alokuara. Algoritmi për Bashkimin e Çmimit përdoret në situatën e bashkimit ose jo të Ankandëve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Anëtar i Bursës | Nënkupton një entitet të pranuar si një anëtar në Bursë në përputhje me Rregullat e ALPEX-it |
| Anëtar i Klerimit | Nënkupton një entitet që ndërmerr veprimtari nëpërmjet EMCS-së për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it dhe është përgjegjës përpara ALPEX-it për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo pjesëmarrje në përputhje me kushtet dhe dispozitat e Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat |
| Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit | Nënkupton një Anëtar Klerimi i cili ka të drejtë të kleroj Transaksionet e kryera nga Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it |
| Anëtar Personal i Klerimit | Nënkupton një Anëtar Klerimi që ka të drejtë të kleroj Transaksionet të kryera prej tij si një Anëtar i Bursës në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Ankand | Nënkupton një ankand i kryer në Segmentin e Tregut të Ditës në Avancë ose Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë |
| Ankand Lokal | Një Ankand i zhvilluar vetëm brenda një Zone Ofertimi |

| | |
|--|--|
| Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton një Ankand në Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë |
| Ankandet Plotësuese Rajonale Brenda së Njëjtës Ditë (CRIDA) | Nënkupton Ankandet Brenda së Njëjtës Ditë që zhvillohen në një zonë e cila përbëhet nga disa Zona Ofertimi , plotësuese të Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës së Ditë |
| Ankandet Lokale Brenda të Njëjtës Ditë (LIDA) | Nënkupton një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë që përfshin Zonat të ndara Ofertimi në Shqipëri ose Kosovë |
| Ankandi i Ditës në Avancë | Nënkupton Ankandin në Segmentin e Tregut të Ditës në Avancë |
| Aplikanti | Nënkupton një entitet ligjor që kërkon të pranohet si Anëtar i Bursës në përputhje me Rregullat e ALPEX-it - Kushtet e Përgjithshme në seksioni C.1. ose të pranohet si Anëtar i Klerimit në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes në seksionin C.2 |
| Aplikimi për Anëtarësim | Nënkupton një formë aplikimi standard i cili duhet të plotësohet nga çdo Aplikant që ka si qëllim të pranohet si Anëtar i Bursës |
| Asetet Funktionale të Bashkimit të Tregjeve | Asetet Funktionale të Bashkimit të Tregjeve janë: Price Matcher Broker (PMB) dhe EUPHEMIA |
| Autoriteti Kompetent | Nënkupton qeverinë e Shqipërisë apo Kosovës, Autoritetin Rregullator të Energjisë të Shqipërisë, Zyrën e Rregullatorit për Energji të Kosovës, Autoritetin e Konkurrencës së Shqipërisë, Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës, Gjykatat Kompetente të Shqipërisë ose Kosovës, Ministrin, Departamentin, Komisionin, Entitetin dhe çdo trupë ndërkombëtare me fuqi dhe kompetence për ti bërë të detyrueshme vendimet, shpërblimin, rregullin ose gjykimet |
| Autoriteti Përkatës | Nënkupton Autoritetin Rregullator ose Autoritet tjetër Kompetent sipas Ligjit në Fuqi |
| Autoriteti Rregullator | Nënkupton ose ERE-n dhe/ose ZRrE-n |
| Autorizimet e Kërkuara | Nënkupton të gjitha licencat, autorizimet, lejet, marrëveshjet, kontratat dhe të tjera aprovime (nëse ka) të cilat mundësohen nga Autoriteti Përkatës dhe që kërkohen për ti mundësuar një Pale të përmbush detyrimet e saj sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat , në përputhje me ligjin në fuqi |
| Banka | Nënkupton një entitet që mban një Licencë Bankare përkatëse |
| Banka për Shlyerje | nënkupton një Bankë Tregtare, nëpërmjet së cilës kryhet shlyerja në para e transaksioneve për tu kleruar nga ALPEX në përputhje me kushtet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |

| | |
|--|---|
| Banka Qendrore | Nënkupton Bankën e Shqipërisë në referim të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Qendrore të Kosovës kur i referohet Republikës së Kosovës |
| Bashkimi Çmimit i Rajoneve (PCR) | Nënkupton një iniciative të nëntë bursave të energjisë evropiane për të zhvilluar një zgjidhje të vetme të bashkimit të çmimit e cila do përdoret për të llogaritur çmimet e energjisë elektrike në Evropës dhe alokimin e Kapacitetit Ndërkufitar |
| Bashkimi i Tregjeve | Nënkupton një mekanizëm për integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të zonave të ndryshme me metodat jo-diskriminuese, në implicit dhe bazë tregu, për formimin e çmimit dhe alokimin e Kapaciteteve Ndërkufitare të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Blllok Vartës | Nënkupton bllokun e varur në pranimin e tij nga pranimi i një tjetër blloku |
| Blloku i Izoluar | Nënkupton Urdhërporositë në Bllok pa Bllloqet e Varura |
| Blloku Udhëheqës | Nënkupton bllokun i cili kushtëzon pranimin e bllloqeve të tjera |
| Borxh i Keq i Pasiguruar | Për të shmangur çdo keqkuptim, ky përkufizim aplikohet vetëm për qëllim të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe nuk ka për qëllim për të nënkuptuar se çdo shumë e caktuar është një “borxh i keq” brenda kuptimit të kësaj shprehje në përkufizimet standarde ose praktike fiskale, financiare ose kontabilitetit |
| Burimet Personale të Dedikuara | Nënkupton burime financiare të paravendosura në dispozicion të ALPEX si një Palë Qendrore për të mbuluar humbjet e mundshme në rast të një Mospërbushje të Detyrimeve nga një Anëtar Klerimi, të cilat tejkalojnë humbjet që janë mbuluara prej Margjinës të mundësuar nga ky Anëtar dhe as nga Fondi i Mospërbushjes së Detyrimeve në përputhje me dispozitat e specifikuar në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Bursa | Nënkupton tregun e organizuar që operohet nga ALPEX duke ofruar tregtimin e energjisë elektrike, klerimin dhe shlyerjen në afatet kohore për tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për livrimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë siç është vendosur në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat. |
| Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) | Nënkupton entitetin përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike me shumicë në Shqipëri në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe në fuqi, dhe në Kosovë bazuar në vendimin e ZRrE-së nr. V_1332_2020 dhe Marrëveshjes ndërmjet KOSTT dhe ALPEX firmosur më dd.mm.2022 |

| | |
|--|--|
| Çifti Çmim-Sasi | Nënkupton një çift çmim-sasi i përfshirë në një Urdhërporosi dhe: (a) në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë, përshkruhet në paragrafin B.1.5.5. të Procedurës së Tregtimit (b) në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë, përshkruhet në paragrafin C.1.5.5 të Procedurës së Tregtimit; dhe (c) në lidhje me Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë, përshkruhet në paragrafin D.1.2.4 të Procedurës së Tregtimit. |
| Çmimi i Ankandit | Nënkupton Çmimin Klerues për një Njësi Kohore Tregu të caktuar i dalë prej Ankandit nga ku të gjitha Kontratat që rrjedhin prej Ankandit dhe që i përkasin kësaj Njësi Kohore Tregu do të shlyen |
| Çmimi i Maksimal i Tregut të Ditës në Avancë | Nënkupton nivelin maksimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë të futura në Ankandin e Ditës në Avancë |
| Çmimi i Minimal i Tregut të Ditës në Avancë | Nënkupton nivelin minimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë të futura në Ankandin e Ditës në Avancë |
| Çmimi Klerues | Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e Urdhërporosive me çmim të pranuar me vlerën më të lartë për shitje me Urdhërporositë me çmim të pranuar me vlerën më të ulët për blerje në tregun e energjisë elektrike |
| Çmimi Klerues i Tregut | Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e Urdhërporosisë Shitjeje të pranuar me çmimin më të lartë me Urdhërporosinë Blerjeje të pranuar me çmimin më të ulët në tregun e energjisë elektrike |
| Çmimi Maksimal i Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë | Çmimi Klerues Maksimal në lidhje me një Ankandi Brenda së Njëjtës Ditë |
| Çmimi Maksimal i Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë | Niveli maksimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë e dorëzuara në Tregun e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë |
| Çmimi Minimal i Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë | Niveli minimal i çmimit të lejuar për Urdhërporositë e futura në Tregun e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë |
| Çmimi Minimal i Ankandit të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë | Çmimi Minimal i Klerimit në respekt të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë |
| CET | Zona Kohore e Evropës Qendrore |

| | |
|------------------------------|---|
| CRIDA-1 | Nënkupton Ankandin e parë të Bashkimit të Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| CRIDA-2 | Nënkupton Ankandin e dytë të Bashkimit të Tregjeve në Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| CRIDA-3 | Nënkupton Ankandin e tretë të Bashkimit të Tregjeve në Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshire Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të realizuar për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| DAM | Nënkupton Tregun e Ditës në Avancë |
| Data e Hyrjes në Fuqi | Nënkupton datën e së cilës një dokument ose marrëveshje hyn në fuqi |
| Data e Pagesës | Nënkupton datën dhe kohën përpara së cilës çdo shumë për tu paguar nën Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes në vijim të termave të tyre duhet të paguhet |
| Debitori i ALPEX | Nënkupton Anëtarin e Klerimit i cili paguan ALPEX-in sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Dita e Fillimit | Nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes siç vendoset nga Autoriteti Rregullator |
| Dita e Klerimit | Nënkupton një Ditë kalendarike në të cilën procedurat e Klerimit kryhen dhe detyrimet dhe të drejtat e Anëtarëve të Klerimit janë llogaritur në bazë të transaksioneve që kanë qenë përmbyllur në Tregjet e Energjisë Elektrike dhe regjistruar në Sistemin e Klerimit. Ditët e Klerimit janë Ditë Pune në përputhje me kalendarin e ditës së klerimit të përcaktuar dhe shpallur nga ALPEX-i |
| Dita e Livrimit | Nënkupton një seri të vazhdueshme të Periudhave të Livrimit e cila fillon në orën 00:00 CET në një Ditë kalendarike dhe mbaron në orën 24:00 CET e së njëjtës Ditë kalendarike |
| Dita e Shlyerjes | Nënkupton Ditën Bankare kur do të bëhet shlyerja përkatëse |
| Dita e Tregtimit | Nënkupton një Ditë kalendarike kur Tregjet e ALPEX-it hapen për Tregtim |
| Ditë | Nënkupton një Ditë kalendarike |

| | |
|---|--|
| Ditë pune | Nënkupton një Ditë jave në të cilën nuk është: (a) një Ditë pushim publik ose Ditë pushim bankar në Shqipëri ose Kosovë; (b) një Ditë jo-pune sipas udhëzimit të Bankës Qendrore të Shqipërisë ose Kosovës , sipas rastit. Termi “Jo-Ditë Pune” do të interpretohet në përputhje me rrethanat |
| Dorëheqje | Nënkupton një aplikim me shkrim për dorëheqje nga Anëtari i Bursës nëse ALPEX është i bindur se ky Anëtar ka përmbushur (ose do të përmbushë deri në kohën kur dorëheqja hyn në fuqi) |
| Ekzekutimi i Garancisë | Nënkupton ekzekutimin nga ALPEX të Letër Garancisë të lëshuar nga banka dhe tërheqjen e një pjese ose të gjithë Kufirit të Kreditit të Anëtarit të Klerimit |
| EMCS - Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë | Nënkupton Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë Elektrike siç përshkruhet në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) | Nënkupton institucionin rregullatorë në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror i cili operon sipas ligjit nr. 43/2015, date 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe në fuqi |
| Entitet | Nënkupton çdo formë organizimi i shoqërive tregtare siç parashikohet në ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar dhe ligji nr.06/L-016 “Për Shoqëritë Tregtare” për Republikën e Kosovës |
| ETSS - Sistemi Elektronik i Tregtimit në Çast | Nënkupton Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast. Sistem tregtimi i cili menaxhon të gjithë proceset e Tregjeve Elektrike, kryen të gjitha llogaritjet, mban të dhënat dhe rezultatet në Tregjet e ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë dhe menaxhon ndërfaqen midis tregjeve të sipërpërmendur me Tregun e Balancimit të operuar nga Operatori përkatës i Sistemit të Transmetimit |
| Euro | Nënkupton njësinë monetare dhe monedhën e Bashkimit Evropian e përfaqësuar me simbolin € |
| Faturë | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.4.2 |
| Fondi i Mospërmbushjes së Detyrimeve | Nënkupton Fondin e krijuar nga ALPEX-i për të mbuluar riskun nga aktiviteti i Klerimit që ai kryen si Kundërpalë Qendrore në përputhje me dispozitat e veçanta të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, duke përfshirë Kapitullin E të saj |
| Furnizues | Nënkupton një mbajtës të licencës për furnizim të energjisë elektrike dhe kryen veprimtaritë e furnizimit |

| | |
|--|---|
| Furnizuesi i Shërbimit Universal | nënkupton një shoqëri sipas përcaktimit në ligjin përkatës për energjinë elektrike të Shqipërisë ose Kosovës |
| Garancia | Nënkupton procesin e vendosur në seksionin G.3. të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Garancia e Vlefshme | Nënkupton Garancinë e mundësuar nga një Anëtar i Klerimit në përputhje me termat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe e cila nuk është vendosur nga ALPEX-i si Margjinë |
| Gjenerues | Nënkupton një entitet ligjor cili prodhon energji elektrike dhe mban një licencë për prodhimin e energjisë elektrike |
| Gjeneruesi Publik | Nënkupton një Gjenerues i energjisë elektrike në pronësi të shtetit të Shqipërisë dhe/ose Kosovës |
| Gjithçka-ose- Asgjë - Kushti (AON) | Ka kuptimin e dhënë në paragrafin D.1.6.4 të Procedurës së Tregtimit |
| Gjykata | Nënkupton një gjykatë brenda sistemit ligjor të Shqipërisë ose Kosovës sipas rastit |
| Grupi Ekskluziv i Urdhërporosive në Bllok | Nënkupton një Urdhërporosi në Bllok që paraqet kushtet dhe vetitë specifike siç mundësohen në paragrafin B.1.9 të Procedurës së Tregtimit |
| IDM | Nënkupton Tregun Brenda së Njëjtës Ditë |
| Informacion Konfidencial | <p>Nënkupton informacionin (në lidhje me një Palë) i cili është përcaktuar me shkrim nga një Palë si konfidencial ose i cili do të mund të konsiderohet të jetë konfidencial prej natyrës së tij dhe i cili është zbuluar në lidhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat, Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, Marrëveshjen Kuadër për Klerim. Informacioni Konfidencial nuk do të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekzistencën e termave të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave, Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë dhe Marrëveshjen Kuadër për Klerim; dhe 2. Regjistrimin e të Dhënave ose informacionin i cili është kërkuar në kohën e përcaktuar për tu publikuar në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, Marrëveshjen Kuadër për Klerim |

| | |
|---|---|
| Informacion mbi Transaksionet në Interkonektor | Nënkupton informacionin e mëposhtëm që vjen nga një Ankand në lidhje me çdo Interkonektor: <ol style="list-style-type: none"> 1. Tregjet e ALPEX-it (i Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë); 2. Interkonektori përkatës ose Agjenti i Transaksioneve 3. Sasi e planifikuar dhe drejtimi i energjisë elektrike të transferuar 4. Njësinë Kohore të Tregut përkatëse; dhe 5. Të tjera informacione sipas Procedurës dhe Kushteve të kërkuara të Klerimit |
| Informacioni i Brendshëm | Nënkupton një informacion të një natyre të përpiktë i cili nuk ka qenë publikuar, i cili lidhet direkt ose indirekt me një ose disa produkte të energjisë elektrike me shumicë dhe të cilat nëse këto do të ishin publikuar me shumë gjasa do të ndikonin çmimet e këtyre produkteve |
| Interkonektor | Nënkupton një linjë transmetimi e cila lidh kufirin midis dy vendeve të cilat lidhin sistemin kombëtar të transmetimit të këtyre vendeve |
| Jo-Anëtar Klerimi | Një Anëtarë i Bursës në Tregjet e ALPEX-it i cili nuk ka kapacitetin e Anëtarit të Klerimit dhe bashkëpunon me të paktën një Anëtar të Përgjithshëm Klerimi për Klerimin e Transaksioneve që ky Anëtarë kryen në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me kushtet e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. |
| Juridiksioni | Nënkupton juridiksionin në Shqipëri ose Kosovë ose të dyja sipas rastit |

K - M

| | |
|---|---|
| Kalendari i Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes | Nënkupton afatet të vendosura nga ALPEX-i gjatë kohës të cilat midis të tjerash specifikojnë afatet kohore dhe periudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve |
| Kalendari i Shlyerjes | Nënkupton një kalendar për Shlyerjen e Transaksioneve e publikuar nga ALPEX |
| Kamatëvonesa | Nënkupton interesin që një Anëtar Klerimi duhet të paguaj nëse dështon të përmbushë detyrimet financiare në kohë dhe vlera e interesit parashikohet nga dispozitat për dështimin e përmbushjes në kohë të detyrimeve monetare |
| Kapaciteti Ndërkufitar | Nënkupton Kapacitetin i sistemit ndërkufitar që vendoset për transmetimin e energjisë midis Zonave të Ofertimit |

| | |
|---|---|
| Kërkesat Ligjore | Nënkupton çdo kërkesë nga legjislacioni primar dhe sekondar, statuti, urdhri, rregulli, rregullorja dhe termat e ndonjë licencë, leje të nxjerra nga ndonjë autoritet përkatës qeveritar |
| Kërkesë e Rregullatorit për Raportim | Nënkupton raportimin e kërkuar nga Autoriteti Rregullator ose Autoritet tjetër Kompetent sipas çdo Ligji në Fuqi për të përpiluar, mbledhur, dhe/ose dorëzuar ndonjë informacion ose të dhënë ose ndonjë sjelljeje ose çështje të lidhura me Bursën ose operimin e saj |
| Klerimi | Nënkupton procesin e zbatuar nga ALPEX-i për të krijuar Pozicionet, duke përfshirë llogaritjen e Kredive ose Debive të Anëtarit të Klerimit kundrejt ALPEX-it, për Llogari Klerimi lidhur me Pozicionin e sipërpërmendur si dhe për të siguruar disponueshmërinë e parasë për të garantuar ekspozimin e ALPEX-it, i cili ngrihet nga këto Pozicione në përputhje me dispozitat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Kodi EIC (Kodet e Identifikimit të Energjisë) | Nënkupton një kod unik identifikimi për Anëtarin e Bursës në të gjitha tregtimet në Tregun e Energjisë Elektrike |
| Koha e Hapjes së Portës | Nënkupton kohën nga e cila Anëtari i Bursës mund të dorëzoj Urdhërporosi në ETSS |
| Koha e Mbylljes së Portës | <ul style="list-style-type: none"> - Në Tregjet e Ditës në Avancë dhe Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë ka kuptimin e Kohës së Mbylljes së Portës së Ankandit - Në Tregtimin e Vazhdueshme Brenda së Njëjtës Ditë nënkupton kohën përfundimtare të Tregtimin për Njësi Kohore Tregu siç specifikohet në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Koha e Mbylljes së Portës për Ankandin | Nënkupton kohën pas të cilës ETSS nuk pranon Urdhërporosi për Segmentin e Tregut dhe Ditës së Livrimit të caktuar |
| Koha e Përcaktuar | Nënkupton kohën specifike të përcaktuar nga një vendim përkatës i lëshuar nga Autoriteti Rregullator prej së cilit aktiviteti i Bursës në tregjet e ALPEX-it do të fillojë |
| Komiteti i Bursës | Nënkupton një komitet konsultativ të zgjedhur nga Anëtarët e Bursës. Roli i tij është të mundësojë këshillim për ALPEX-in përmes konsultimeve dhe të promovoj që Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat të mbeten të përditësuara me kalimin e kohës |
| Konsumator | Nënkupton një entitet i cili merr energji elektrike për përdorim vetjak |
| Kontrata | Nënkupton që Palët bien dakord të përmbushin detyrimet për shitje ose blerje të energjisë elektrike në Tregjet e ALPEX-it |

| | |
|--|---|
| Kontrata e Bashkimit të Tregjeve | Nënkupton Palët të rëna dakord për të përmbushur detyrimet për shitjen dhe blerjen e energjisë në Bashkimin e Tregjeve të ALPEX-it |
| Kontratat OTC | Nënkupton tregtimin e brendshëm afatgjatë i cili do të bazohet në një kontratë financiare dypalëshe ku energjia elektrike do të tregtohet përmes Bursës |
| Kontributi Fillestar | Nënkupton një kontribut përkatës në para të dhënë nga Anëtari Klerimit për Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve në mënyrë që të fitojë kapacitetin përkatës |
| Kontributi Minimal | Nënkupton një kontribut minimal në para të dhënë nga Anëtari i Klerimit për Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve |
| Kosova | Nënkupton Republikën e Kosovës |
| Kreditori i ALPEX | Nënkupton Anëtarin e Klerimit i cili paguhet sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Kufiri i Kreditit | Nënkupton kufirin financiar të kërkuar dhe mundësuar nga Anëtari i Klerimit sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, procedurë e cila është e zbatueshme për Anëtarin e Bursës për të vendosur Urdhërporosi dhe të kryej Transaksion në Tregjet ALPEX-it |
| Kufiri i Tregtimi | Nënkupton vlerën monetare deri në të cilën një Anëtar i Bursës mund të tregtoj për një periudhë të caktuar |
| Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në lidhje me një Ankand Brenda së Njëjtës Ditë |
| Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë | Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në një Ankand të Ditës në Avancë |
| Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit të Dytë | Nënkupton Çmimi Klerues Maksimal i pranuar në lidhje me një Ankand të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit të Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton Çmimi maksimal i përpthur i pranuar për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë |
| Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë | Nënkupton Çmimi Klerues Minimal i pranuar në një Ankand të Ditës në Avancë |
| Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Ankandit të Dytë | Nënkupton Çmimi Klerues Minimal i pranuar në lidhje me një Ankand të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |

| | |
|--|--|
| Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit të Tregut Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton Çmimi Klerues Minimal të pranuar në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë. |
| Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton Çmimi i përputhur minimal i pranuar për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë |
| Kufizimet në Alokim | Nënkupton kufizimet që duhen respektuar gjatë alokimit të kapacitetit për të mbajtur sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë operationale dhe që nuk ka qenë përfshirë si Kapacitet Ndërkufitar |
| Kufizimi i Ankandit | Për ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, nënkupton një situatë ku Kurba e Grupuar e Urdhërporosi Blerjeje dhe Kurba e Grupuar e Urdhërporosi Shitjeje në Ankand nuk do të priten brenda Kufirit të Lejuar të Çmimit Maksimal dhe Minimal |
| Kundërpalë | Nënkupton çdo Palë kundrejt ALPEX-it |
| Kundërpalë Qendrore | Nënkupton ALPEX-in që vendoset në mes të Palëve për Kontratat e dala nga Tregjet e ALPEX-it |
| Kursi i Këmbimit | Nënkupton kursin zyrtar të këmbimit midis monedhës Lekë dhe Euro të publikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë të Ditës përpara Ditës së Livrimit |
| Kushtet e Licencës për NEMO | Nënkupton Kushtet e NEMO të përcaktuar në Licencën e ALPEX-it |
| Kushtet e Përgjithshme | Nënkupton dokumentin e hartuar nga ALPEX dhe aprovuar nga Autoriteti Rregullatorë i quajtur si Rregullat e ALPEX-it |
| Kushtet për Klerim | Nënkupton rregullat, procedurat termat dhe kushtet e ALPEX-it në rolin e tij si Kundërpalë Qendrore |
| Kushti | Nënkupton një kusht nga i cili një Urdhërporosi është subjekt i saj, siç përshkruhet në Procedurën e Tregtimit |
| Kushti i Vlefshëm Deri në Datën- (GTD) | Nënkupton kushtin e vlerësimit të një Urdhërporosie të futur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.5(a) të Procedurës së Tregtimit |
| Kushti i Vlefshëm për Sesionin- (GFS) | Nënkupton kushtin e vlerësimit të një Urdhërporosi të futur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.5(b) të Procedurës së Tregtimit |

| | |
|--|---|
| Kushti Kushti Prano ose Largo - Fill-Or-Kill | Nënkupton kushte ekzekutimi në Urdhërporositë të vendosura në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë siç përcaktohet në paragrafin D.1.6.2 të Procedurës së Tregtimit |
| Kushti Pa Kushte (None-NON) | Kusht Ekzekutimi mbi një Urdhërporosi të vendosur në Zgjidhjen e Tregtimit Brenda së Njëjtës Ditë siç parashikohet në paragrafin D.1.6.1 të Procedurës së Tregtimit |
| Kushti, Ekzekutoje Menjëherë ose Fshije - (Immediate-or-Cancel) | Kushti mbi një Urdhërporosi të vendosur në Zgjidhjen e Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të mundësuar në paragrafin D.1.6 të Procedurës së Tregtimit |
| Legjislacioni i Mbrojtjes së të Dhënave | Nënkupton Rregullat dhe në çdo rast të gjitha rregullat , statutet dhe instrumentet të krijuara dhe të ndryshuara rregullisht dhe ndonjë legjislacion tjetër i aplikueshëm i cili zbatohet duke përfshirë ndonjë ndryshim ose zëvendësim të tij |
| Lekë | Nënkupton njësinë monetare dhe monedhën e Shqipërisë e përfaqësuar me simbolin ALL |
| Letër Garanci Bankare | Nënkupton një dokument të lëshuar nga Banka që garanton ALPEX-in që do të paguhet për detyrimet që rrjedhin nga Transaksioni në Tregjet e ALPEX-it në rast se Anëtari Klerimit përkatës do të jetë në kushtet e Mospërbushjes së Detyrimeve. Forma e saj vendoset nga Vendimi Teknik |
| Lëshuesi i Letër Garancisë (LoG) | Nënkupton një entitet që mban një licencë përkatëse bankare dhe në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Libri e Urdhërporosive | Nënkupton përmbledhjen ku Urdhërporositë futen në ETSS nga Anëtarët e Bursës për tregtimin në Tregun me Shumicë të Energjisë Elektrike ku Produktet janë renditur |
| Libri i Urdhërporosisë Lokale | Nënkupton një libër të Urdhërporosive të operuar nga NEMO të veçanta |
| Libri i Urdhërporosive te Grupara | Nënkupton një modul në Sistemin Bashkimit të Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë që mbledh të gjitha Urdhërporositë e përputhura nga NEMO-t që marrin pjesë në Bashkimin e Vetëm Brenda së Njëjtës Ditë dhe kryerjen e përputhjes së vazhdueshme të këtyre Urdhërporosive |
| Licenca e Operatorit të Tregut | Nënkupton licencën për të veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike nën ligjin e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës sipas rastit |

| | |
|------------------------------------|--|
| Licencë | Nënkupton një të drejtë të dhënë tek një entitet ligjor për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin energjisë elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar , licencën e gjeneruesit të energjisë elektrike , licencën e furnizuesit të energjisë elektrike, licencën e tregtarit të energjisë elektrike, licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, licencën e Operatorit të Tregut ose ndonjë licencë siç kushtet mund ta kërkojnë të lëshuar nga Autoriteti Rregullator |
| Licencë Bankare | Nënkupton një licence lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë ose e Kosovës sipas rastit |
| LIDA-1 | Nënkupton Ankandin e parë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| LIDA-2 | Nënkupton Ankandin e dytë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| LIDA-3 | Nënkupton Ankandin e tretë Lokal të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë duke i konsideruar Zonat e Ofertimit AL dhe KS dhe/ose Zona të tjera Ofertimi të ndara, e kryer për një Ditë Livrimi duke mbuluar Njësinë Kohore të Tregut në Ditën e përcaktuar të Livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të Procedurës së Tregtimit |
| Ligji/Legjislacioni në Fuqi | Nënkupton çdo instrument statusor, legjislativ ose rregullatorë siç aplikohet tek Palët |
| Lista e Tarifave të ALPEX | Nënkupton deklaratën e tarifave të publikuar në çdo kohë nga ALPEX për qëllim të Aktiviteti të tij të aprovuar nga Autoritetit Rregullator përkatës sipas rastit |
| Llogari e Klerimit | Nënkupton llogarinë e Personale të Klerimit ose Llogarinë e Klerimit të Anëtarit të Bursës sipas rastit |
| Llogari Përdoruesi | Nënkupton një identitet individual hyrës (log-in), që përfshin emër përdorimi, çelës sigurie, karte sigurie personale, kodin PIN, fjalëkalimin ose kredenciale të tjera për të aksesuar ose pajisje që i përkasin një identiteti të tillë të hyrjes (log-in) të ofruara për të hyrë në ETSS |
| Llogari Personale Klerimi | Llogari e mbajtur në EMCS nga Anëtari Personal i Klerimit nën emrin e tij për Klerimin e Transaksioneve të kryera nga ai në rolin e Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it |

| | |
|---|--|
| Llogaria Bankare e ALPEX | Nënkupton llogarinë bankare në emër të ALPEX-it të mbajtur në Bankën për Shlyerje, në dhe nga kryhen Pagesat dhe Tarifa e Tregtimit sipas Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Llogaria bankare e Garancisë në Para | Nënkupton llogari e përbashkët bankare e krijuar nga Anëtari i Klerimit dhe ALPEX-i, në emër të ALPEX-it sipas seksionit G.2.2 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për qëllim të formimit të një pjese ose të gjithë Kufirit të Kreditit për Anëtarin të Klerimit |
| Llogaria bankare për Shlyerje | Nënkupton një llogari të përbashkët bankare e ALPEX-it dhe Anëtarit të Klerimit dhe ndonjë nën llogari të saj, e mbajtur në Bankën për Shlyerjen, me qëllim kryerjen e shlyerjeve në para të Transaksioneve të Energjisë Elektrike në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Llogaria e Klerimit të Anëtarit të Bursës | Nënkupton një llogari në Sistem e mbajtur nga një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi në emër të një Anëtarit të Bursës në Tregjet e ALPEX-it për Klerimin e Transaksioneve në këto Tregje për këtë Anëtar |
| Llojet e Urdhërporosive | Kuptimi i dhënë në seksionin B.1.3 të Procedurës së Tregtimit |
| Manipulimi i Tregut | Ka kuptimin e dhënë në Artikullin (1.3) të Rregullit REMIT |
| Margjinë | Nënkupton margjinën e kërkuar që është llogaritur nga ALPEX-i në respekt të Anëtarit të Klerimit në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes me qëllim të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të Anëtarit të Klerimit në lidhje me Transaksionet në Tregun e energjisë Elektrike të kleruar prej tij |
| Marrëveshje Anëtarësimi në Bursë | Nënkupton një dokument të nënshkruar nga ALPEX dhe Aplikanti për hyrje në Tregjet e ALPEX në mënyrë që të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Marrëveshje Kuadër për Klerim | Nënkupton marrëveshjen sipas së cilës një entitet obligohet të zbatoj Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Mjeti Elektronik i Emëruar | Nënkupton një mjet elektronik të përzgjedhur nga ALPEX-i me qëllim që të krijojë komunikime me Anëtarët e Bursës dhe/ose me Anëtarët e Klerimit |
| Modeli Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri | Nënkupton Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.519, Datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” |
| Moduli i Menaxhimit të Kapaciteteve | Nënkupton sistemin që përmban informacionin e përditësuar lidhur me Kapacitetet e vlefshme Ndërkufitare me qëllim shpërndarjen e Kapaciteteve Ndërkufitare për Tregtimin e Vazhdueshëm |

| | |
|--------------------------------------|---|
| Monedha | Nënkupton Euro në Shqipëri dhe Kosovë dhe Lekë në Shqipëri dhe "Monedhat" do të interpretohen në përputhje me rrethanat |
| Mosmarrëveshje | Nënkupton ndonjë pretendim, mosmarrëveshje, ose diferenca të çfarëdo lloj natyre kurdoherë që lindin prej ose në lidhje me Rregullat e ALPEX-it, ose Procedurat ose Marrëveshja a Anëtarësimit në Bursë ose Marrëveshja Kuadër për Klerimi |
| Mosmarrëveshje Konflikt | Nënkupton një Mosmarrëveshje në lidhje me një konflikt të pretenduar midis Rregullave të ALPEX-it apo Procedurave dhe Kërkesave Ligjore të tjera përkatëse |
| Mosmarrëveshje e Përgjithshme | Nënkupton një Mosmarrëveshje e cila nuk përfshihet në ndonjërin prej kategorive të Mosmarrëveshjes së Aderimit dhe Konfliktit duke përfshirë një Mosmarrëveshje në lidhje me pagesat sipas Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurat |
| Mosmarrëveshje për Pranimin | Nënkupton një Mosmarrëveshje që vjen si pasojë e Procesit të Pranimit |
| Mospërbushja e Detyrimeve | Nënkupton kur Anëtari i Bursës dhe/ose Anëtari i Klerimit është në thyerje të ndonjë dispozite të Rregullave të ALPEX-it, ose Procedurave ose Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë ose Marrëveshjes Kuadër për Klerim dhe që përfshin pa limituar një dështim në pagimin e një shume parash ose një thyerje të një ose me shumë dispozitave të sjelljes të dokumenteve të sipërpërmendur |
| Muaj | Nënkupton një muaj kalendarik |
| Mungesë | Nënkupton, kur ndonjë nga Anëtarët e Klerimit dështon të kryejë ndonjë pagesë të parashikuar në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes deri në Datën për tu Paguar, shumën e papaguar së bashku me ndonjë interes të aplikuar |

N - S

| | |
|--|---|
| Ndalimi i Tregtimit | Nënkupton një pezullim të përkohshëm për tregtim në Bursë |
| Ndarja ose Ndarja e Tregut | Nënkupton situatën në të cilën Procesi i Bashkimit të Çmimit është ndërprerë dh/ose anuluar |
| Ndërfaqja e Programimit të Aplikacionit (API) | Nënkupton Ndërfaqen e programuar të aplikacioneve |
| Ndikues në Çmim | është një Anëtar i Bursës i cili është i aftë të influencojë në Çmimin e Klerues të Tregut dhe ta pranojë atë për shlyerjen e Transaksioneve të tij |

| | |
|---|---|
| Ndryshim | Nënkupton një ndryshim të dispozitave të Rregullave të ALPEX-it ose Procedurave |
| NEMO | Nënkupton Operatorin e Tregut të Emëruar të Energjisë Elektrike i përcaktuar sipas Rregullit të NEMO të Shqipërisë dhe/ose Kosovës sipas rastit |
| Ngjarje Papajtueshmërie | Nënkupton një ngjarje që ekziston nëse një Anëtar i Bursës në opinionin e arsyeshëm të ALPEX-it: <ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk përmbush detyrimet e tij nën një rën prej dokumenteve dhe/ose marrëveshjeve ku janë palë të Rregullave të ALPEX-it dhe Procedurave; ose 2. Është në shkelje të Ligjit në Fuqi dhe kjo shkelje ndikon ose do të ndikojë në aftësinë e Anëtarit të Bursës të veprojë në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe dokumentacionin që lidhet me të |
| Ngjarje Papajtueshmërie Materiale | Ka kuptimin në paragrafin D.3.2.2 të Rregullave të ALPEX-it |
| Ngjarje për shkak të Forcës Madhore | Nënkupton çdo ngjarje e cila parashikohet si ngjarje e Forcës Madhore të përcaktuar nga ligji në fuqi në Shqipëri dhe Kosovë. |
| Njësia Kohore Tregu | Nënkupton periudhën për të cilën çmimi i tregut krijohet ose periudhën me të shkurtër të mundshme për dy Zona Ofertimi , nëse Njësitë Kohore të Tregut janë të ndryshme |
| Njoftim për Mospërmblidhje | Nënkupton një njoftim me anë të një dokumenti të dërguar nga ALPEX-i tek një Palë kur ka një Mospërmblidhje |
| Njoftim për Pranimin | Nënkupton një dokumenti i cili specifikon kur një Palë do të pranohet si Anëtar Klerimi |
| Njoftim për Tregun | Nënkupton çdo deklaratë të nxjerrë në mënyrë elektronike nga ALPEX për të komunikuar me të gjitha Palët |
| Njoftimi për Mospërmblidhje Detyrimesh | Nënkupton një njoftim që ALPEX-i do të lëshojë për Anëtarin e Bursës dhe/ose Anëtarin e Klerimit i cili është në Mospërmblidhje të Detyrimeve duke specifikuar natyrën e kësaj Mospërmblidhjeje |
| Norma e Kontributit | Nënkupton normën e kontributit të vendosur prej Vendimeve të ALPEX-it |
| Norma e Pranimit | Nënkupton sasinë e pranuar të energjisë elektrike nga një Urdhërporosi në Blllok, e cila është pjesë e energjisë elektrike së ofertuar. Norma e Pranimit mund të jetë zero ose ndërmjet Normës Minimale të Pranimit (e specifikuar për një Urdhërporosi në Blllok) dhe njësisë (1). Norma e Pranimit mund të lidhet edhe me Urdhërporosi të Lidhura në Blllok dhe Grupit Ekskluziv të Urdhërporosisë në Blllok |

| | |
|--|---|
| Norma Minimale e Pranimit | Norma Minimale e Pranimit në çdo Urdhërporosi në Bllok, në të cilin Blloku që mund të përputhet dhe vlera e secilës është më pak se ose i barabartë me 100% |
| Numri Regjistrimit Tatimor | Ka kuptimin e dhënë në Ligjin në Fuqi |
| Objektivi i ALPEX-it | Ka kuptimin e dhënë në Termat e Përgjithshme në paragrafin A.1.2 |
| Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve | Nënkupton entitetin i cili kryen detyrat për përputhjen e Urdhërporosive për Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për Zona të ndryshme Ofertimi dhe alokimin e njëkohshëm të Kapaciteteve Ndërkufitare |
| Operator Sistemi, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT) | Ka kuptimin e dhënë në Ligjin në Fuqi nr.05/L-085 “Për energjinë elektrike” |
| Operatori e Bashkimit të Tregjeve (MCO) | Nënkupton detyrat për përputhjen e Urdhërporosive nga Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për Zona të ndryshme Ofertimi dhe alokimin e njëkohshëm të Kapaciteteve Ndërkufitar |
| Operatori i Energjisë së Rinovueshme | Nënkupton operatorin që kryen funksionet e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme siç parashikohet në Ligjin përkatës për Burimet e Rinovueshme |
| Operatori i Sistemit të Transmetimit | Nënkupton një entitet përgjegjës për operimin, garantimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe që përfshin mbajtjen e një licencë për operimin e sistemit të transmetimit të dhënë nga Autoriteti Rregullator |
| Operatori i Tregut | Nënkupton ALPEX sh.a dhe KOSTT sh.a të ndara në rolet e tyre përkatëse të vendosura nga autorizimet e Autoriteteve Rregullatore sipas Licencës së tyre si Operator Tregu dhe çdo përjashtimi tjetër për administrimin e Procedurës së Tregtimit dhe zbatimin e funksioneve të “Operatorit të Tregut” nën këtë Procedurë |
| OST | Nënkupton një entitet i cili është i licencuar nga ERE për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të Shqipërisë |
| Pagesat e Tregtimit | Nënkupton pagesat e Kontratës që rezultojnë nga tregtimi në Tregun e Ditës së Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Pala | Nënkupton ALPEX-in, Anëtarin e Bursës , Anëtarin e Klerimit ose çdo person ose entitet i prekur direkt ose indirekt nga Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Pala e Prekur | Nënkupton një Palë të përfshirë dhe ALPEX-in që preket nga Forca Madhore |

| | |
|---|--|
| Pala në Mosmarrëveshje | Nënkupton një Palë në Mosmarrëveshje |
| Pala në Mospërmbushje Detyrimesh | Nënkupton një Palë që është në Mospërmbushje të Detyrimeve |
| Pala Përgjegjëse për Balancim | Ka kuptimin siç përcaktohet në Rregullat e Tregut të Balancimit |
| Pala Zbuluese e Informacionit | Nënkupton një Palë që zbulon Informacion Konfidencial |
| Parimi e ALPEX-it | Ka kuptimin e dhënë në Termat e Përgjithshme në paragrafin A.1.2 |
| Përfundim Vullnetar | Nënkupton Përfundimin vullnetar me vullnetin e tij si Anëtar Klerimi në përputhje me seksionin F.3. të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes |
| Përfundimi | Nënkupton Përfundimin statusit të Anëtarit të Bursës |
| Përkufizime | Nënkupton dokumentin Përkufizimet e ALPEX-it përdorur në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Përputhja | Nënkupton mënyrën e tregtimit përmes të cilat Urdhërporositë Shitjeje u caktohen Urdhërporosive përkatëse Blerjeje për të siguruar maksimizimin e tepicës ekonomike për Bashkimet e Tregjeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Përputhja në Grup | Nënkupton përputhjen e Urdhërporosive në Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë që do të ndodhë në rast të rritjes së Kapacitetit Ndërkufitar |
| Pezullim | Nënkupton procesin prej ku ALPEX-i pezullon anëtarësimin e një Anëtari të Bursës në përputhje me Urdhër-Pezullimin |
| Pjesa Proporcionale | Në referencë të Anëtarit të Klerimit nënkupton shumën përkatëse të depozituar në para nga ky Anëtar në llogarinë bankare të Fondit për Mospërmbushje të Detyrimeve |
| Portofoli | Nënkupton një llogari elektronike e mbajtur nga ALPEX për çdo Anëtar të Bursës ku Urdhërporositë për Shitje/Blerje mund të vendosen |
| Pozicione | Detyrimet dhe të drejtat korresponduese në para që vijnë nga Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX-it dhe që nuk janë shlyer akoma |
| Pozicioni Neto | Nënkupton shumën të neto të importit ose eksportit të energjisë elektrike për çdo Njësi Kohore Tregu për një Zone Ofertimi |

| | |
|---|--|
| Pranimi | Nënkupton procesin iniciues sipas të cilit një Aplikant bëhet i pranueshëm për të vazhduar procedurën për përmbushjen e kërkesave teknike, ligjore, dhe ekonomike të përcaktuara nga ALPEX deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë |
| Pranues i Çmimit | Është një Anëtar i Bursës i cili dorëzon Urdhërporosi pa çmim Blerje ose Shitje dhe i cili duhet të pranojë Çmimin Klerues të Tregut përkatës për shlyerjen e Transaksioneve të tij |
| Procedura Alternative | Nënkupton një proces alternativ i përdorur për llogaritjen e Çmimit Klerues të Tregut në rast të dështimit të Aseteve Funktionale të Bashkimit të Tregjeve |
| Procedura e Alokimit të Kapaciteteve | Nënkupton Rregullat për Harmonizimin e Alokimit të Kapaciteteve Ndërkufitare e kryer nga SEE CAO dhe aprovuar nga bordi i ERE-s me vendim nr. 124 datë 21.07.2016 dhe bordi i ZRrE-së me vendim nr. V_1317_2020 të datës 12.11.2020 |
| Procedurat | Nënkupton procedurën e detajuar që duhet të ndiqet nga Palët në kryerjen e detyrimeve dhe funksioneve të tyre nën Rregullat e ALPEX-it |
| Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes | Nënkupton dokumentin e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes aprovuar nga Autoriteti Rregullator i cili përcakton termat e aktivitetit të klerimit dhe shlyerjes për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë në tregjet e ALPEX-it |
| Procedurat e Komitetit të Bursës | Nënkupton një dokument të zhvilluar prej ALPEX-it që vendos role, mbledhje, konfidencialitete dhe përbërje të Komitetit të Bursës |
| Procedura e Tregtimit | Nënkupton një dokument i përgatitur nga ALPEX-it dhe aprovuar nga Autoriteti Rregullator përkatës |
| Procesi i Aderimit | Nënkupton procesin që ndiqet nga një Aplikant për të fituar kapacitetin e Anëtarit të Klerimit |
| Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes | Nënkupton procesin e zgjidhjes së Mosmarrëveshjes midis Anëtarit të Bursës/Anëtarit të Klerimit dhe ALPEX në lidhje me Rregullat e ALPEX-it, ose Procedurave ose Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë ose Marrëveshjen Kuadër për Klerim |
| Procesi për Ndryshim | Nënkupton procesin e paraqitjes, vlerësimit dhe pranimit ose refuzimit të Propozimeve për Ndryshim dhe bërjes së këtyre Ndryshimeve |
| Produkt | Produktet e energjisë elektrike me shumicë të cilat tregtohen në Tregjet e energjisë Elektrike në përputhje me përkufizimet e tyre dhe dispozitat specifike |

| | |
|---|---|
| Propozim për Ndryshim | Nënkupton çdo propozim i cili është paraqitur tek ALPEX-i për të ndryshuar, korrigjuar ose përshtatur Rregullat e ALPEX-it ose Procedurat |
| Propozues | Në lidhje të një Propozimi për Ndryshim, nënkupton një Palë që ka të drejtën për të paraqitur Propozimet për Ndryshim për këto rregulla të ALPEX-it dhe Procedurat |
| REMIT | Nënkupton rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të energjisë elektrike me shumicë të publikuar nga Autoriteti Rregullatorë i Shqipërisë ose i Kosovës sipas rastit |
| Rezultatet Paraprake të Tregut të Bashkuar | Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve të cilat dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve tek NEMO-t me qëllim të vlerësimi |
| Risku Brenda së Njëjtës Ditë | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.5.2 |
| Rregullat e ALPEX-it | Nënkupton një grup dispozitash të përfshira në Kushtet e Përgjithshme, i ndryshuar kohë pas kohe në të cilën ALPEX do të zbatojë detyrat sipas ligjeve në fuqi dhe përmban rregullat nga të cilët Anëtarët e Bursës do të tregtojnë në Bursë dhe Anëtarët e Klerimit do të klerojnë Transaksionet |
| Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike | Nënkupton normat që rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike midis pjesëmarrësve dhe marrëdhëniet midis palëve në tregjet e energjisë elektrike, operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit me qëllim mbajtjen e balancës fizike në treg |
| SDAC | Bashkimi i Ditës në Avancë në një të Vetëm |
| SEE CAO | Nënkupton Zyrën e Koordinuar për Ankandet në Evropën Jug-Lindore |
| Segmenti i Tregut | Ka kuptimin e dhënë në Ankandin e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë dhe Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë. Një Segment Tregu përbëhet nga një Zone Ofertimi e lidhur me një Procedurë Tregtimi dhe Njësi Kohore e Tregut siç përcaktohet në Procedurën e Tregtimit |
| Shlyerja | Nënkupton procesin që kryhet ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarëve të Klerimit ku nëpërmjet të cilit ALPEX-i menaxhon shlyerjet në para për Transaksionet e përfunduara në tregjet e ALPEX-it |
| Shlyerja e Transaksioneve | Nënkupton procesin e lëvizjes së mjeteve monetare ndërmjet llogarive bankare të palëve që marrin pjesë në shlyerjen e transaksioneve, ka kuptimin e dhënë në seksionin G.3.4 |

| | |
|--------------------------------|--|
| Shlyerja në Para | Nënkupton procesin e zbatuar nga ALPEX-i me Anëtarët e Klerimit për pagesën e detyrimeve dhe arkëtimin e të drejtave të cilat rrjedhin nga klerimi i Transaksioneve të Energjisë Elektrike në përputhje me Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes |
| Shqipëria | Nënkupton Republikën e Shqipërisë |
| Shtojcë | Nënkupton një shtojcë të Proceduarve dhe termi “Shtojcë” do të interpretohet në përputhje me rrethanat |
| Sistemet e Anëtarit | Nënkupton sistemet e Anëtarit të Bursës të përdoruar për transmetimin dhe marrjen e të dhënave në Bursë |
| Sjellja në Treg | Nënkupton përgjegjësi për çdo Anëtar të Bursës për të garantuar përputhshmërinë me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat e cila duhet të respektohet dhe të vepohet sipas saj gjatë gjithë kohës |
| Skedulimi i Tregut | Skedulimi i energjisë neto (Pozicioni Neto) që rezulton nga tregtimi në të gjitha Tregjet e ALPEX-it, i cili transferohet nga ALPEX-i tek sistemi i menaxhimit të tregut të OST-së dhe KOSTT-it për qëllimin e balancimit të sistemit të transmetimit ose përdoret për proceset e tjera siç janë Klerimi dhe Shlyerja, etj |
| Specifikimi i Produktit | Nënkupton specifikimet për Segmentet e tregut në Ankandin Ditës në Avancë, Brenda së Njëjtës Ditë dhe Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë të Bursës të listuar në Shtojcën A të Procedurës së Tregtimit |

T - Z

| | |
|------------------------------------|---|
| Tarifa Fikse Administrative | Nënkupton një Tarifë fikse të përgjithshme në Listën e Tarifave të ALPEX-it që një Aplikant do të paguaj me qëllim që aplikimi i tij të shqyrtohet |
| Tarifa Fikse e Aderimit | Nënkupton një Tarifë fikse për tu paguar tek ALPEX-si nga një Aplikant për të fituar kapacitetin e Anëtarit të Klerimit |
| Tarifa Fikse e Anëtarësimit | Nënkupton një Tarifë Fikse për tu paguar tek ALPEX-i nga një Aplikant për pranimin si Anëtar i Bursës |
| Tarifa Fikse Vjetore | Nënkupton një Tarifë Fikse për tu paguar tek ALPEX nga një Entitet për vazhdimin e marrëdhënieve si Anëtar i Bursës dhe/ose Anëtar i Klerimit siç parashikohet në Lista e Tarifave të ALPEX |
| Tarifë Fikse | Nënkupton një vlerë monetare fikse e paguar tek ALPEX-i nga Anëtari i Bursës ose Anëtari i Klerimit siç parashikohet në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat dhe Listën e Tarifave |

| | |
|--|--|
| Tarifë Variabël | Nënkupton një vlerë monetare variabël e paguar nga Anëtari i Bursës për tregtim dhe Klerim në Tregjet të ALPEX-it |
| Tatimi i Vlerës së Shtuar | (a) nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar të ngarkuar sipas dispozitave të Ligjit në fuqi në lidhje me Shqipërinë, Ligjit Shqiptar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, (i ndryshuar) ; ose (b) në respekt të Kosovës, Ligjin përkatës të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, (i ndryshuar) dhe përfshin çdo taksë zëvendësuese ose të ngjashme që vendoset për furnizimin e mallrave ose shërbimeve |
| Të Dhënat | Nënkupton çdo informacion lidhur me tregun e energjisë elektrike |
| Të Dhënat për Pjesëmarrje | Nënkupton kategoritë e të dhënave të mëposhtme: 1. Informacionin e kërkuar për të fituar dhe mbajtur kapacitetin e Anëtarit të Bursës; Fjalëkalimin e përdoruesit të autorizuar për të pasur mundësi qasje në ETSS; |
| Të dhënat për Tregtimin | Nënkupton një listë me informacione të tilla si çmimi, kuotat e kërkesës/ofertës dhe volumi i tregut |
| Të Dhënat Personale | Ka kuptimin e vendosur në Ligjin Shqiptar Nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar, prej ligjit Nr. 48/2012, datë 26.04.2012 i ndryshuar dhe për Kosovën Ligji Nr. 06/L-082 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” |
| Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale | Nënkupton të drejtat (të tanishme dhe të ardhshme) patentat, shpikjet, të drejtat për projektet, të drejta për bazën e të dhënave, sekretet tregtare, njohuritë, çdo aplikacion për regjistrimin e ndonjëres të sipërpërmendura dhe ndonjë të drejte pronësie industriale ose intelektuale të çfarë do lloj natyre, e regjistruar apo jo, që ekziston tani ose në të ardhmen kudo në botë |
| Të Drejtat për Transmetim Fizik apo PTR | Nënkupton një e drejtë kombëtare të dhënë nga OST-të tek ALPEX-si për të sistemuar transferimin e energjisë nëpër Interkoneksion për një Njësi Kohore të Tregut me drejtim, sasi dhe çmim të përcaktuar nga zgjidhja e Bashkimit të Çmimit |
| Transaksioni ose Transaksioni i Energjisë Elektrike | Nënkupton Transaksionet në Produktet të cilat janë realizuar në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me kushtet e Rregullave së ALPEX-it dhe Procedurat |
| Tregjet e ALPEX-it | Përfshin Tregjet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë duke përfshirë Ankandet dhe Tregtimin e Vazhdueshëm i cili operon si një treg i energjisë elektrike me shumicë i organizuar në të cilin Transaksionet klerohen nga ALPEX-i |
| Tregtar | Nënkupton një entitet ligjor mbajtës i një licence tregtimi të energjisë elektrike të lëshuar nga Autoriteti përkatës rregullator |

| | |
|--|---|
| Tregtimi i Vazhdueshëm | Nënkupton një Tregti të kryer në Segmentin e Tregut Brenda së Njëjtës Ditë |
| Tregtimi i Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton procesin e tregtimit në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë për përputhjen e Urdhërporosive dhe alokimin e Kapaciteteve Ndërkufitare në mënyrë të vazhdueshëm |
| Tregtimi i Vazhdueshëm Pan-Evropian Brenda së Njëjtës Ditë (XBID) | Nënkupton një platformë elektronike e përdorur si pjesë e operimit të Tregtimit të Vazhdueshëm Pan-Evropian Brenda së Njëjtës Ditë |
| Tregtimi/ Tregtia | Nënkupton një kontratë që rezulton nga tregtimi në Tregjet e Ditës në Avancë ose Brenda së Njëjtës Ditë |
| Tregu Balancues | Përkufizimi sipas ligjit përkatës |
| Tregu Brenda së Njëjtës Ditë | Nënkupton tregun e ALPEX ku transaksionet kryhen për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me detyrimin e livrimit fizik, pas skadimit të kufirit të kohës për dorëzimin e Urdhërporosive për transaksionet në tregun e Ditës në Avancë dhe të lidhura me Ditën e Livrimit në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi si dhe Procedurën Klerimit dhe Shlyerjes |
| Tregu i Alokimit të Kapaciteteve | Nënkupton tregun për alokim të Kapaciteteve Ndërkufitare të kryer nga SEE CAO |
| Tregu i Ditës në Avancë | Nënkupton tregun e energjisë elektrike ku dorëzimi i Urdhërporosi Blerjeje dhe Shitjeje të vendosura në ditën para livrimit në intervalin prej Kohës së Hapjes së Portës deri në Kohën e Mbylljes së Portës |
| Tregu i Energjisë Elektrike | Përfshin tre tregje si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Tregu i Alokimit të Kapaciteteve 2. Tregu i Organizuar me Shumicë 3. Tregu i Balancimit |
| Udhëzim Bankar | Nënkupton formën e instruksionit lidhur me termat në të cilën paraja mbahet në Llogarinë e Garancisë në Para |
| Urdhër për Pezullim | Nënkupton një urdhër të nxjerrë nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës, kur ALPEX arrin në konkluzionin që ky Anëtar nuk po vepron në përputhje me kërkesat e Rregullave të ALPEX-it ose Procedurat |
| Urdhër Përfundimi | Nënkupton një urdhër të nxjerrë nga ALPEX-i për Anëtarin e Bursës, ku specifikohen kushtet e Përfundimit, koha dhe data prej kur ky përfundim hyn në Fuqi |
| Urdhërporosi | Nënkupton një ofertë për të shitur ose një kërkesë për të blerë energji elektrike nga një Anëtar i Bursës brenda Zonës së Ofertimit të Shqipërisë ose Kosovës, në lidhje me një Portofol të caktuar, Njësi kohore Tregu, volum dhe çmim në përputhje me specifikimet e Produkteve të lidhura |

| | |
|---|--|
| Urdhërporosi në Bllok | <p>(a) Në lidhje me Urdhërporositë e dorëzuara për Ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, nënkupton Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje për më shumë se një Njësi Kohore Tregu me karakteristikat e përshkruara në seksionin B.1.7 të Procedurës së Tregtimit</p> <p>(b) Në lidhje me Urdhërporositë e dorëzuara në Tregtimin e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë nënkupton një Urdhërporosi Blerjeje ose Shitjeje për më shumë se një Njësi Kohore Tregu me karakteristikat e përshkruara në seksionin D.1.2 të Procedurës së Tregtimit</p> |
| Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) | Urdhërporositë Marrëse e Çmimit me Përparësi janë Urdhërporosi me hapa orare (blerjeje/shitjeje) të dorëzuar për një çmim të barabartë me (maksimum/minimum) e Kufirit të Lejuar të Çmimit në Ankandet e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë |
| Urdhërporosi Ajsberg | Nënkupton një Urdhërporosi me karakteristikat e përshkruara në paragrafin D.1.3 të Procedurës së Tregtimit |
| Urdhërporosi Blerjeje | Nënkupton një deklaram me qëllim blerjeje i futur në ETSS nga Anëtari i Bursës për të kryer Tregtim në Tregun e Energjisë Elektrike në përputhje me dispozitat specifike në Rregullat e ALPEX-it |
| Urdhërporosi e Thjeshtë | Nënkupton në Urdhërporosi, dhe: <p>(a) në lidhje me Ankandin e Ditës në Avancë e përshkruar në paragrafin B.1.5 të Procedurës së Tregtimit; dhe</p> <p>(b) në lidhje me Ankandin Brenda së Njëjtës Ditë, e përshkruar në paragrafin C.1.5 të Procedurës së Tregtimit;</p> |
| Urdhërporosi e Thjeshtë Blerjeje | Një Urdhërporosi e Thjeshtë për blerjen e energjisë elektrike |
| Urdhërporosi e Thjeshtë Shitjeje | Një Urdhërporosi e Thjeshtë për të shitur energji elektrike |
| Urdhërporosi në Bllok të Pranuar Paradoksisht | Një Urdhërporosi në Bllok e cila është pranuar në klerimin e Tregun të Ditës në Avancë ndërsa është përtej vlerës financiar (out-of-money) |
| Urdhërporosi Orare të Grupuar | Kurba e vetme që rezulton nga të gjitha Urdhërporositë Blerjeje ose Shitjeje të të gjithë Anëtarëve të Bursës në të njëjtën Zonë Ofertimi për çdo Njësi Kohore Tregu |
| Urdhërporosi Shitjeje | Një deklaram i qëllimit për shitje e vendosur nga një Anëtar i Bursës në ETSS për kryerjen e tregtimeve në Tregjet e ALPEX-it në përputhje me dispozitat e specifikuar në Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat |
| Urdhërporosi Shitjeje në Bllok | Një Urdhërporosi në Bllok për të shitur Energji Elektrike |

| | |
|--|--|
| Urdhërporosi të Lidhura në Bllok | Një Urdhërporosi në Bllok, duke paraqitur kushtet specifikeve dhe karakteristikat siç mundësohen në paragrafin F.1.8 të Procedurës së Tregtimit |
| Vendim Teknik | Nënkupton një vendim të nxjerrë nga ALPEX-i në përputhje me Rregullat e ALPEX-it dhe Procedurat të cilat parashikojnë çështjet teknike, procedurale dhe operacionale me natyre jo-rregullative |
| Vendimet e ALPEX | Një vendim i lëshuar nga ALPEX dhe njofton Palët |
| Vendimet nga Autoritetet Rregullatorë | Nënkupton një vendim të marrë nga ERE dhe/ose ZRrE lidhur me tregun e Shqipërisë dhe/ose të Kosovës sipas rastit |
| Vetëfaturimi | Nënkupton lëshimin e një fature nga ALPEX në emër të Anëtarit të Bursës i cili rezulton nga tregtimi në Tregjet e ALPEX-it si shitës i energjisë elektrike |
| Viti | Nënkupton një periudhë e cila fillon prej orës 00:00 të datës 01 Janar dhe mbaron në orën 24:00 të datës tjetër më 31 Dhjetor |
| Zonë Ofertimi | Nënkupton zonën gjeografike brenda së cilës pjesëmarrësit e tregut kanë mundësi të shkëmbejnë energjinë elektrike pa alokim të kapaciteteve |
| Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) | Nënkupton Autoritetin Rregullator Kombëtar i cili është themeluar në Qershor 2004, me shpalljen e tij nga Parlamenti i Kosovës bazuar në Ligjin e Rregullatorit të Energjisë |